

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË
FAKULTETI EKONOMIK
DEPARTAMENTI: BIZNES DHE MENAXHMENT
SPECIALIZIM: BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET



PUNIM DIPLOME

EGZON ABDULLAHI

Mitrovicë, 2024

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË
FAKULTETI EKONOMIK
DEPARTAMENTI: BIZNES DHE MENAXHMENT
SPECIALIZIM: BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET



PUNIM DIPLOME

TITULLI I PUNIMIT:

**FAKTORËT E ANALIZËS KREDITORE DHE VLERËSIMI I AFTËSISË KREDITORE
TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË BANKAT KOMERCIALE NË
KOSOVË**

Mentori:

Prof. Asoc. Dr. Qazim Tmava

Kandidati:

Egzon Abdullahi

UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICA
FACULTY OF ECONOMICS
DEPARTMENT: BUSINESS AND MANAGEMENT
SPECIALIZATION: BANKING, FINANCE AND ACCOUNTING



BACHELOR THESIS

TOPIC TITLE:

**FACTORS OF CREDIT ANALYSIS AND CREDIT ASSESSMENT OF SMALL AND
MEDIUM ENTERPRISES BY COMMERCIAL BANKS IN KOSOVO**

Mentor:

Prof. Asoc. Dr. Qazim Tmava

The candidate:

Egzon Abdullahi

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË
FAKULTETI EKONOMIK
BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET
SPECIALIZIM: BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET



PUNIM DIPLOME

Lënda: Menaxhment bankar

Titulli i punimit: Faktorët e analizës kreditore dhe vlerësimi i aftësisë kreditore te ndërrmarjet e vogla dhe të mesme në bankat komerciale në Kosovë

Emri dhe mbiemri: Egzon Abdullahi

Statuti i studentit: I rregullt

Numri i amzës(ID Regjistri): 2005031035

Niveli i studimeve: Baçelor

Departamenti: Banka, Financa dhe Kontabilitet

Programi i studimit: Banka, Financa dhe Kontabilitet

Mentori i punimit: Prof. Asoc. Dr. Qazim Tmava

Aprovuar prej komisionit:

1. _____ Mentor

/Emri Mbiemri, Titulli /

2. _____ Anëtar

/Emri Mbiemri, Titulli /

3. _____ Anëtar

/Emri Mbiemri, Titulli /

Data e aprovimit: _____

Falënderime

Fillimisht do të falenderoj familjen time e cila ishte me mua në çdo hap të jetës, e po ashtu edhe në rrugën time të studimeve. Ky sukses që kam arritur deri sot nuk do ishte i mundur pa përkrahjen dhe motivimin që kam pasur çdoherë nga familja ime, kolegët e mi, pa lënë anash edhe profesorët e mi të nderuar.

Falënderim i veçantë është edhe për Universitetin e Mitrovicës “ Isa Boletini “, institucionin i cili ka një staf që punojnë me profesionalizëm të madh dhe janë të përkushtuar ndaj studentëve.

Falenderoj shumë edhe mentorin, Prof. asoc. Dr. Qazim Tmava, për ndihmën e pakursyer gjatë gjithë kohës së studimeve dhe posaqërisht gjatë hartimit të punimit të diplomës, ndihma e të cilit ka ndikuar shumë që punimi të jetë më i arrirë profesionalisht. Ju faleminderit professor, nga zemra.

Ju faleminderit të gjithëve!

Egzon Abdullahi

Deklarata e Originalitetit / Autorësisë

Ky Punim Diplome i nivelit baçelor është puna ime origjinale duke respektuar autorësinë e çdo burimi të informacioneve dhe rregullave për një punim të mirëfilltë shkencorë, dhe nuk është dorëzuar, në tërësi apo pjesërisht, për ndonjë gradë në këtë apo ndonjë universitet tjetër.

Sipas njohurisë time, punimi nuk përmban asnjë material të botuar apo shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç siç deklarohet në brendi të tekstit.

Gjithashtu, deklaroj se, në shkrimin e punimit kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të UMIB.

Statement of Originality / Authority

This Diploma Thesis, bachelor level, is my original work, respecting the authorship of any source of information and rules for a proper scientific work, and has not been submitted in whole or in part to any degree at this or any other university.

According to my knowledge, the paper does not contain any material published or written by any other person except as stated in the text.

Also, I declare that writing the thesis I have respected the ethical rules of the scientific and academic work of UMIB.

Data/ Date: _____

Studenti

signature)

(nënshkrimi-

Abstrakti

Roli dhe rëndësia e NVM-ve në zhvillimin ekonomik të Kosovës është i rëndësishëm dhe i pakontestueshëm për ekonominë vendore dhe jo vetëm.

Ky punim ka për qëllim të hulumtojë se cilët janë faktorët në të cilët bazohen bankat komerciale gjatë vlerësimit të analizës kreditore të NVM-ve, me rastin e aplikimit për kredi, qoftë për qarkullim apo investime. Me këtë rast duhet theksuar se rëndësi të madhe kanë pasqyrat financiare të cilat tregojnë suksesin ose dështimin e një biznesi. Bizneset kohë pas kohe kanë nevojë për kredi nga ndërmjetësit financiar si burime të jashtme të financimit, për rritjen dhe zgjerimin e tyre.

***Fjalët kyqe:** NVM, financim, pasqyrat financiare, bankat komerciale, kredia.*

ABSTRACT

The role and importance of SMEs in Kosovo's economic development is important and uncontrollable for the local economy and not only.

This paper aims to investigate what are the factors on which commercial banks are based in assessing the credit analysis of SMEs, in case of application for loans, whether for turnover or investments. In this case, it should be noted that the financial statements that indicate the success or failure of a business are of great importance. Businesses need loans from financial intermediaries as external sources of financing, for their growth and expansion.

Key words: SMEs, financing, financial statements, commercial banks. Loan.

Përmbajtja

1. Hyrje	11
1.1. Përkufizimi i problemit	11
1.2. Qëllimi.....	11
1.3. Metodat e hulumtimit.....	12
2. Rishikimi i literaturës.....	12
2.1. Çka janë NVM-të (BVM-të)?	12
2.2. Rëndësia e bizneseve të vogla	13
2.3. Çka janë bankat?.....	14
2.4. Kategorizimi i bankave	15
2.4.1. Banka Qendrore	15
2.4.2. Banka komerciale.....	16
3. Sistemi kreditor	17
3.1. Kredia.....	18
3.2. Kontrata e kredisë	19
3.2.1. Përmbajtja e kontratës mbi kredisë	19
4. Pasqyrat financiare.....	19
4.1. Bilanci i gjendjes.....	20
4.2. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	22
4.3. Pasqyra e fitimeve të mbajtura.....	23
4.4. Pasqyra e Cash Floë	23
4.5. Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	24
SHEMBUJ:	24
5. Kredidhënia në Kosovë dhe vlerësimi i aftësisë kreditore	28
5.1. Vlerësimi i aftësisë kreditore nga ana e bankave	28
5.2. Faktorët e formimit të potencialit kreditor.....	29
5.3. Kreditimi bankar me afat të shkurtër.....	30
5.3.1. Kreditimi i organizatave ekonomike	30
5.3.2. Kreditimi i veprimtarive joekonomike	32
5.3.3. Kreditimi i bankave afariste.....	32
5.3.4. Kreditimi i prodhuesve bujqësore	32
5.3.5. Kreditë konsumuese	32
5.3.6. Kreditimi i tregtisë së jashtme.....	33
5.4. Kreditimi bankar me afat të gjatë.....	34

6. Faktorët e vlerësimit të aftësisë kreditore të klientit.....	35
Konkluzione.....	39
Rekomandime.....	40
Literatura.....	43
Thënie për sukseset.....	42
Thënie për bizneset.....	43

● **LISTA E TABELAVE**

- Tabela 1. Struktura e bilancit të gjendjes 23
- Tabela 2. Struktura e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve 24
- Tabela 3. Struktura e pasqyrës së fitimeve të mbajtura 25
- Tabela 4. Struktura e pasqyrës Cash Flow 25

LISTA E FIGURAVE

- Figura 1. Rëndësia e bizneseve të vogla 13
- Figura 2. Kreditë në vitin 2020 në USD në Kosovë (Burimi: Ceic Data) 37
- Figura 3. Kreditë në vitin 2021 në USD në Kosovë (Burimi: Ceic Data) 37
- Figura 4. Kreditë në vitin 2022 në USD në Kosovë (Burimi: Ceic Data) 38
- Figura 5. Kreditë e këqija në Kosovë Janar 2022-Shkurt 2023 në % (Burimi: Ciec Data) 39

LISTA E SHKURTESAVE

- NVM – Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
- KMSH – Kostoja e mallit të shitur
- SKK – Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
- BE – Bashkimi Evropian
- EUR-Euro
- ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

1. Hyrje

Bizneset janë organizata që krijojnë vlera për klientin (Peter Drucker).

“Çdo biznes i madh fillon i vogël.” (Richard Branson).

Në ditët e sotme bizneset janë çdo herë e më shumë pjesë e çështjeve kryesore të një shteti duke përfshirë këtu edhe ekonominë pasi me hapjen e bizneseve të tyre po ofrojnë mundësi edhe për vende të reja të punës, e cila po ndikon në zbutjen e shkallës së papunësisë së një vendi dhe po rrit standardin jetësor të tij.

1.1. Përkufizimi i problemit

Pavarësisht përpjekjeve të institucioneve Kosovare po ashtu edhe lehtësirave që bankat /institucionet financiare në Kosovë po ua ofrojnë në forma të ndryshme me qëllim që t’i përkrahin bizneset e vogla ende bizneset kanë nevojë të vetëdisohen në fushën e të bërit biznes dhe të jenë më bashkëpunues me institucionet. Punimi tenton të hulumtojë faktorët që ndikojnë në analizat kreditore që bëhen nga ana e bankave komerciale në Kosovë si dhe ku ka ngecje gjatë këtyre analizave dhe ku po gabojnë bizneset apo të themi ku nuk po janë të kujdesshëm.

1.2. Qëllimi

Qëllimi i këtij punimi është që të shqyrtojmë faktorët të cilët t’i marrin parasysh bankat komerciale me rastin e vlerësimit të aftësisë kreditore me rastin e aplikimit të NVMve për kredi bankare, si dhe vlerësimit të aftësisë kreditore të tyre.

Përmes këtij punimi është njohja me analizën e pasqyrave financiare dhe me rëndësinë e saj për marrjen e vendimeve lidhur me lejimin apo refuzimin e kredisë, për NVM-të.

1.3. Metodatat e hulumtimit

Gjatë realizimit të këtij punimi, në vijim do t'i cekim metodatat të cilat i kemi përdorur janë përdorur lidhur me analizimin e materialit, me çrast na kanë shërbyer si bazë shkencore për trajtim, analizë nxjerrje të konkluzimeve dhe dhënje të rekomandimeve, për kategori të ndryshme akterësh:

- Metoda historike;
- Metoda e analizës dhe sintezës,
- Metodatat matematiko-statistikore,

2. Rishikimi i literaturës

2.1. Çka janë NVM-të (BVM-të)?

Definimi NVM-ve varion ose ndryshon në vende të ndryshme. Sot në botë egzistojnë mbi 70 përkufizime të NVM-ve. Mirëpo që të gjitha përkufizimet pajtohen që NVM-të janë ndërmarrje apo grupe ndërmarrjesh me më pak se 250 të punësuar. NVM-të janë konsideruar si shtylla kryesore e çdo ekonomie qofshin ato të zhvilluara apo në zhvillim pasi ato kanë një potencial të madh për krijimin e vendeve të punës, gjenerim të fitimit, ashtu edhe për rritjen dhe inovacionin.

NVM-të janë ofruesi kryesor i vendeve të punës dhe i rritjes ekonomike.

Përkufizimi i ndërmarrjeve sipas kritereve të BE-së dhe Bankës Botërore, sipas kriterit të numrit të punësuarve, përkufizim i cili është i akceptuar edhe në Kosovë. Andaj përkufizimi NVM-ve është si në vijim:

- Mikro-ndërmarrje: 0 – 9 punëtorë,
- Ndërmarrje të vogla: 10 – 49 punëtorë,
- Ndërmarrje të mesme: 50- 250 punëtorë dhe
- Ndërmarrje të mëdha: 250 e më shumë punëtorë.

Kemi dy tipe bizneseve të vogla dhe të mesme:

1. Bizneset për të nxjerrë fitim, ku fitimi është diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve. Kjo do të thotë se këto biznese prodhojnë mallra (p.sh. benzin, makina apo kompjuterë) ose shërbime (prekje e flokëve, larje rrobash apo veprime bankare) për fitim dhe

2. Bizneset që quhen organizata jo fitmprurëse (OJQ-të e ndryshme). Objektivi kryesor i tyre është të sigurojnë mallra dhe shërbime për shoqërinë pa pasur qëllim nxjerrjen e fitimit.

2.2.Rëndësia e bizneseve të vogla




Figura 1. Rëndësia e bizneseve të vogla

Biznesi i vogël kontribuon në produktivitetin e çdo vendi në disa mënyra:

- ❖ Ata stimulojnë ndryshimin në sektorin e biznesit, proces i njohur si shkatërrim krijues.
- ❖ Ata janë laborator i shpikjeve dhe i risive falë aftësisë për t'iu përgjigjur me shpejtësi teknologjisë së re dhe kushteve- konkurruese të tregut.
- ❖ Ata janë punëdhënësit më të mëdhenj në shumicën e vendeve dhe hapin shumë mundësi për vende të reja pune për shumë punëtorë.

2.3. Çka janë bankat?

Fjala bankë kryesisht mendohet se rrjedh prej fjalës italiane “banco” që do të thotë tavolinë-tezgë (bankë). Në kuadër të sistemit financiar, bankat llogariten që kanë pjesëmarrjen më të madhe në kuadër të tërë sistemit, andaj edhe llogariten si ndërmjetësit financiar më të rëndësishëm si ekonomitë në zhvillim ashtu edhe tek ato të zhvilluara.

Funksioni i parë i bankave ishte këmbimi i parasë, pasi që atëherë kanë ekzistuar lloje të ndryshme të parave metalike me kualitete dhe peshë të ndryshme. Bankat kanë kryer detyrën e arkëtimit, të ruajtësit dhe të ndërmjetësuesit, kështu që punët e ndërmejtësimit, punët depozitare dhe punët kreditore konsiderohen si funksionet kryesore të bankave.

Përkufizimi i bankës:

Banka është institucion financiar i veçantë i cili në mënyrë profesionale merret me marrjen dhe dhënien e kredisë si dhe me ndërmjetësimin në qarkullimin e pagesave të komitentëve.

Esenca e kuptimit të bankës është marrja dhe dhënia e kredisë që paraqet veprimtarinë kryesore të saj. Në pikëpamje teorike dhe funksionale, punët financiare të bankës rreth krijimit të parave si dhe të ndërmjetësimit financiar janë funksionet themelore të bankës.

Funksioni i krijimit të parave do të thotë botimi i kartëmonedhave si dhe krijimi i depozitave bankiere ose të parave-llogari.

Funksioni i ndërmjetësimit financiar paraqet ndërmjetësimin e bankës në mes të sektorëve të ndryshëm (organizatave ekonomike, shtetit, popullsisë etj.) të cilët kanë tepricë(suficit) të mjeteve financiare dhe të sektorëve të cilëve u mungojnë (deficit) mjetet financiare. Ky funksion ka të bëjë me mbledhjen (akumulimin) e mjeteve monetare prej organizatave të ndryshme, institucioneve , popullsisë si dhe subjekteve tjera, të cilat mjete për një kohë pronarët e tyre nuk kanë nevojë, dhe bartjen e tyre në ato subjekte të cilat kanë nevojë për ato para. Pra, banka në mënyrë të ndryshme bën mbledhjen apo koncentrimin e mjeteve monetare, në ç’rast paraqitet si debitor, dhe me anë të procesit të kreditimit ato mjete ua lë në dispozicion subjekteve të cilave u janë të nevojshme, në ç’rast paraqitet si kreditor.

2.4. Kategorizimi i bankave

Në kuader të çdo sistemi financiar , sistemi bankar kategorizohet në dy nivele: Niveli i Bankës Qendrore dhe niveli i dytë – bankat komerciale.

Banka Qendrore trajtohet si bankë e bankave dhe mbi të gjitha është përgjegjëse për stabilitetin monetar në vend.

Ndërsa bankat e nivelit të dytë, operojnë drejtpërdrejtë me ekonomi varësisht prej asaj se si ato i sigurojnë mjetet dhe në ç'mënyrë i shfrytëzon ato, klasifikohen si në vijim:

1. Banka emetuese(emisionare) ose qendrore,
2. Banka depozitare ose komerciale,
3. Banka të specializuara ose të degëve,
4. Banka universale,
5. Banka investive,
6. Banka afariste,
7. Banka për zhvillim,
8. Banka regjionale,
9. Monobanka,
10. Arkat e kursimit dhe
11. Bankat multinacionale.

2.4.1. Banka Qendrore

Banka Qendrore është banka kryesore në systemin financiar e cila i rregullon marrëdhëniet monetare dhe kreditore të një vendi. Banka Qendrore si institucion financiar i sistemit monetar është e detyruar që të kujdeset për vlerën e njësisë monetare të vendit, për rregullimin e qarkullimit të parave dhe të likuiditetit të sistemit banker si dhe për likuiditetin në vend dhe ndërkombëtar. Banka Qendrore është banka e vetme e autorizuar për emisionin e kartëmonedhave dhe të monedhave si mjet ligjor i pagesës në vendin përkatës.

Banka Qendore kryen këto punë respektivisht ka këto funksione:

- 1) E drejta e emisionit të parave dhe të kredisë,
- 2) Zbaton politikën kreditore-monetare,
- 3) Zbaton dhe kujdeset për politikën e likuiditetit ndërkombëtar,
- 4) Kryen punë në llogari të shtetit.

2.4.2. Banka komerciale

Bankat depozitare ose komerciale mjetet e veta i krijojnë prej dispozitave afatshkurtra të organizatave ekonomike dhe prej dispozitave të kursimit të popullsisë, andaj quhen banka depozitare. Njëkohësisht janë banka të cilat sipas afateve të burimit të mjeteve të cilat kryesisht janë afatshkurtra, japin kredi me afat të shkurtër për qarkullimin e mallrave dhe për veprimtari tjera. Së këndejmi, këto banka quhen edhe banka komerciale. Bankat depozitare janë lloji i bankave më të përhapura dhe më të shumta në botë. Prandaj ato janë bazë e sistemit të ndërmjetësimit financiar, sepse me punët e tyre i mobilizojnë depozitat prej komitentëve (organizatave ekonomike, veprimtarive tjera dhe prej popullsisë) prej të cilave i lejojnë kreditë me qëllim të plotësimit të kërkesave të ekonomisë me mjete të mjaftueshme monetare.

Karakteristikë e këtyre bankave është se kanë shumë komitente dhe shumë filiale të organizuara sipas parimit territorial. Prandaj me rëndësi është edhe funksioni monetar i bankave depozitare, përkatësisht komerciale, sepse ato për çdo ditë në mënyrë aktive duke bërë kreditimin me afat të shkurtër bëjnë emisionin e parave, në ç'rast shumë ndikojnë në rritjen, d.m.th. ndryshimin e sasisë monetare dhe në likuiditetin e një vendi. Gjithashtu këto banka në llogari të komitentëve të veta i kryejnë edhe punët e llojllojshme të qarkullimit të pagesave në vend dhe në botën e jashtme.

Ky lloj i bankave pothuajse në të gjitha vendet ka rol kryesor në punët bankiere depozitare dhe kreditore, andaj janë kanali kryesor i krijimit të parave dhe të likuiditetit dhe të ndikimit të shtetit dhe të organeve monetare në realizimin e politikës monetare-kreditore.

Parimet afarist të bankave

Parimet e afarizmit bankier të cilat janë realizuar dhe respektuar, prej të gjitha bankave janë:

1. Parimi i likuiditetit,
2. Parimi i sigurimit dhe
3. Parimi i rentabilitetit.

Me parimin e likuiditetit të bankave duhet nënkuptuar aftësinë e bankave që në afate të caktuara t'i kryejnë të gjitha obligimet e veta.

Në lartësinë e rezerves së likuiditetit, të cilën bankat e ndajnë në formë të normës (përqindjes) sipas politikës afariste të saj, ndikim kanë:

1. Transaksionet monetare (në para) të komitentëve;
2. Politika e likuiditetit të bankave dhe
3. Politika monetare e bankës qendrore.

Parimi i sigurimit në afarizmin bankier përbëhet në mundësinë e pagesës ose të arkëtimit të të gjitha obligimeve ose të kërkesave në afat të caktuar.

Banka duhet të merr parasysh jo vetëm atë se a do t'i kthehet kredia në kohë të caktuar, por duhet të vërtetojë të gjitha faktet e domosdoshme mbi arsyeshmërinë dhe leverdinë ekonomike të çdo kërkesë të kredisë, të aftësisë kreditore dhe se kreditë e tilla do t'i japin efektet e dëshiruara.

Parimi i rentabilitetit në bankë paraqet fitimin i cili realizohet në ndryshimin në mes të të hyrave dhe të dalave të bankës. Ky parim është parimi primar i afarizmit të bankave. Realizimi i profitit sa më të madh në ndryshimin në mes të kamatës aktive dhe pasive ose duke marrë pjesë drejtpërdrejt në aktivitetin ekonomik është politika kryesore afariste e bankave.

3. Sistemi kreditor

Sistemi kreditor paraqet lidhjen organike të elementeve, të faktorëve, të institucioneve si dhe të determinanteve tjera në të cilat bazohet mënyra e krijimit dhe metodogjia e marrëdhënieve kreditore-debitore në mes të subjekteve të ndryshme të reproduksionit shoqëror. Sistemi kreditor është i rregulluar me dispozita lligjore të cilat paraqesin normat dhe rregullat sipas të cilave duhet

t'u përmbahen subjektet ekonomike. Sistemi kreditor është pjesë e sistemit financiar dhe ndërshyryllat kryesore të tijë andaj mund të thuhet se funksionimi efikas i sistemit kreditor nënkupton një sistem efikas financiar dhe në përgjithësi sistem efikas ekonomik.

3.1. Kredia

Fjala kredi rrjedh nga fjala latine "credo" që do të thotë besim.

Kredia paraqet një kuptim real ekonomik-juridik me të cilin nënkuptohet marrëdhënia e caktuar debitorë-kreditorë, e bazuar në transferimin e të drejtës së disponimit me para (ose të ndonjë sendi tjetër) nga ana e kreditorit në dobi të debitorit për kohë të caktuar dhe me kushte të caktuara (mbulesa, kamata, afati, mënyra e pagesës etj.). Kjo do të thotë se kredia paraqet një shërbim të përkohshëm të cilin kreditori ia bën debitorit duke ia lënë në dispozicion ndonjë fuqi blerëse (para), përkatësisht ndonjë vlerë, por duke ruajtur pronësinë e saj dhe të drejtën e arkëtimit të shpërblimit në formë të kamatës. Pra, mund të themi se kredia është një marrëdhënie pronësore juridike në mes të kreditorit dhe debitorit, në të cilën njëra palë (kreditori) ia lënë, ndërsa pala tjetër (debitori) i merr mjetet e caktuara në kohë të caktuar në shfrytëzim me një shpërblim dhe kushte tjera të kontraktuara.

Te kredia ekziston parimi i kthimit të kredisë, d.m.th. obligimi i debitorit që kredinë e marrë pas një afati të caktuar t'ia kthejë kreditorit.

Për kredi është karakteristike kamata dhe afati i kthimit. Kamata është shpërblimi të cilin ia paguan debitori kreditorit për shfrytëzimin e mjeteve në një përqindje, madhësia e të cilës varet prej kërkesës së kredisë, zhvillimit ekonomik, stabilitetit të parave, të tregut etj.

Afati i kthimit të kredisë ka rëndësi për të dy palët. Kreditori është i interesuar që mjetet debitori t'ia kthejë në afat të caktuar të cilat mund t' shfrytëzojë për plotësimin e nevojave të veta ose për qëllime të tjera.

3.2. Kontrata e kredisë

Me kontratën mbi kredinë institucioni bankar zotohet që shfrytësuesit të kredisë t'ia vë në dispozicion një shumë të caktuar parash për kohë të caktuar apo të pacaktuar për destinimin e parashikuar apo të paparashikuar kurse shfrytëzuesi zotohet që bankës t'ia paguajë kamatat e kontraktuara dhe t'ia kthejë shumën e parave të marra në kohën dhe në mënyrën e përcaktuar me kontratë.

Kontrata mbi kredinë është dyanshëm detyruese ngase përveç detyrimit të bankës - ekziston edhe detyrimi i shfrytësuesit që të paguajë kamatën dhe ta kthejë kryegjënë si dhe t'i përmbushë detyrimet e tjera për të cilat është zotuar me kontratë.

3.2.1. Përmbajtja e kontratës mbi kredinë

Elementet kryesore të kontratës mbi kredinë janë: shumta e kredisë, kushtet e dhënies së kredisë, kushtet e shfrytëzimit, kushtet e kthimit të kredisë.

Me rastin e lidhjes së kontratës mbi kredinë banka është ajo që duhet t'u përmbahet uzansave bankare dhe zakoneve të mira afariste. Kjo është arsyeja pse ligjet dhe të gjitha dispozitat e tjera, zakonet afariste, uzansat dhe praktikatat e gjithëmbarshme përbëjnë systemin e kontratave bankare mbi kredinë.

Me rastin kur lidhet kontrata konkrete duhet të kihet parasysh të gjitha burimet e së drejtës mbi kontratën e të drejtës mbi kontratën për kredinë kështu që krahas elementeve kryesore që janë përcaktuar nga ligji, duhet që të merren parasysh edhe konstrukti i gjithëmbarshtëm financiar i punës.

Përmbajtja mbi kredinë kryesisht varet nga lloji i kredisë.

4. Pasqyrat financiare

Pasqyrat financiare janë shumë me rëndësi për secilën ndërmarrje me qëllim kredidhënien, nëse pasqyrat financiare të ndërmarrjeve janë në rregull atëherë do të jenë në rregull edhe me bankën. Pasqyrat financiare po ashtu janë pjesa thelbësore e informacioneve financiare të biznesit pasi që ato tregojnë rezultatet e kaluara të biznesit si dhe parashikimet e saj për të ardhmen.

Pasqyrat financiare janë raporte të kontabilitetit, që ofrojnë informata të përgjithësuara për shfrytëzuesit.

Pasqyrat financiare janë:

- Bilanci i gjendjes
- Bilanci i suksesit (pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve)
- Pasqyra e rrjedhës së parasë (Cash Flow) dhe
- Ndryshimi i kapitalit.
- Dhe për korporata Pasqyra e Fitimeve të Mbajtura.

4.1. Bilanci i gjendjes

Bilanci i gjendjes apo pasqyra e pozitës financiare është një pasqyrë e sistematizuar e mjeteve dhe e burimeve të mjeteve, të klasifikuara nëpër llogari të veçanta duke respektuar dispozitat ligjore, sepse me ligj caktohen llogaritë, emërtimi i tyre, simbolet numerike dhe përmbatja e tyre.

Bilanci kontabël pasqyron gjendjen e mjeteve dhe të burimeve të tyre në një çast, ndërsa bilanci i suksesit përfshin ngjarjet që kanë ndodhur brenda një periudhe të caktuar kohore.

Bilanci ka tre përbërës kryesorë:

1. Aktivet që kontrollon njësia ekonomike raportuese,
2. Pasivet që duhet të përmbushë njësia ekonomike raportuese dhe
3. Kapitalin e pronarëve të njësisë ekonomike raportuese.

Ekuacioni i bilancit të gjendjes:



Tabela 1. Struktura e bilancit të gjendjes

Nr	Përshkrimi	Shuma	Nr.	Përshkrimi	Shuma
	ASETET AFATSHKURTA			DETYRIMET AFATSHKURTA	
1	Paraja		1	Llogari të pagueshme	
2	Llogaria e arkëtuar		2	Dëftesa të pagueshme	
3	Shpenzimet e parapaguara		3	Paga të pagueshme	
4	Furnizimet		4	Të ardhurat e pafituara	
5	Inventari i mallit		5	Kreditë bankare	
I	Gjithsej ASETET AFATSHKURTA (I=1+2+3+4+5)		6	Interesi i pagueshëm	
	ASETET AFATGJATA		7	TVSH e pagueshme	
	Asetet e prekshme		I	Gjithsej DETYRIMET AFATSHKURTA (I=1+2+3+4+5+6+7)	
1	Ndërtesa			DETYRIMET AFATGJATA	
2	Toka		1	Dëftesa të pagueshme afatgjata	
3	Paisjet		2	Pengu i pagueshëm	
	Asetet e paprekshme		3	Lizingu i pagueshëm	
4	Godwill(emri i mirë)		4	Obligacionet e pagueshme	
5	Patentat		II	Gjithsej DETYRIMET AFATGJATA (II=1+2+3+4)	
6	Licencat			EKUITETI I PRONARËVE	
7	E drejta e autorit		1	Aksionet e zakonshme	
8	(zhvlerësimi i grumbulluar)		2	Aksionet e preferuara	
II	Gjithsej ASETET AFATGJATA (II=1+2+3+4+5+6+7-8)		3	Kapitali i pronarit	
III	Gjithsej ASETET(III=I+II)		4	Fitimet e mbajtura	
			5	Rezervat e kapitalit	
			6	(Humbja)	

			III	Gjithsej EKUITETI (III=1+2+3+4+5+6)	
			IV	GJithsej DETYRIMET + EKUITETI (IV=I+II+III)	

4.2. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve është një raport formal i operacioneve të biznesit brenda një periudhe të caktuar kohore. Kjo pasqyrë tregon diferencën në mes të ardhurave nga shitja e mallrave dhe shërbimeve si dhe shumës së shpenzuar për të operuar biznesi. Diferenca njihet si fitim(profit) neto apo humbje neto.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve njihet edhe si bilanci i suksesit, dhe është një regjistër i të hyrave të gjeneruara dhe shpenzimeve të ndodhura për një periudhë kohore.

Tabela 2. Struktura e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve

Nr.	Përshkrimi	Shuma
1	Të hyrat nga shitja	
2	Kostoja e mallit të shitur (KMSH)	
3	FITIMI BRUTO (3=1-2)	
	SHPENZIMET OPERATIVE	
1	Shpenzimet e rrymës	
2	Shpenzimet e pagave	
3	Shpenzimet e ujit	
4	Shpenzimet e mirëmbajtjes	
5	Shpenzimet e zhvlerësimit	
6	Shpenzimet e qirasë	
7	Shpenzimet tjera administrative	
8	Gjithsej SHPENZIMET OPERATIVE (8=1+2+3+4+5+6+7)	
9	Fitimi(të ardhurat)operative (9=3-8)	
10	Shpenzimet e kamatës	
11	Fitimi(të ardhurat)para tatimit(11=9-10)	

12	Shpenzimet e tatimit	
13	Fitimi (e ardhura) neto i periudhës(13=11-12)	

4.3. Pasqyra e fitimeve të mbajtura

Pasqyra e fitimeve të mbajtura shpjegon ndryshimet që nevojiten në procionin e fitimeve të mbajtura të kapitalit aksionar gjatë një periudhe kohe të nevojshme për transaksionet e biznesit (të ardhurat neto) dhe pagesat e bëra pronarëve në formë të dividendëve të cilat janë kthimet e aksionarëve për investimin e tyre në biznes. Të ardhurat e mbajtura pasqyrohen vetëm në pasqyrat e paraqitura nga korporatat.

Tabela 3. Struktura e pasqyrës së fitimeve të mbajtura

Nr.	Përshkrimi	Shuma
1	Fitimet e mbajtura në fillim 01.01.të vitit xxxx	
2	Të ardhurat neto për vitin vijues	
3	Totali (3=1+2)	
4	Dividentet	
5	Fitimet e mbajtura në fund 31.12. të vititi xxxx	

4.4. Pasqyra e Cash Flow

Pasqyra e cash flow klasifikon tre tipet kryesore të aktivitetit të biznesit – investuese, financuese dhe operacionale dhe tregon se si cash arrihet gjatë një periudhe, si ky cash përdoret, dhe cash i rezultuar në bilanc.

Tabela 4. Struktura e pasqyrës Cash Flow

Nr.	Përshkrimi
1	Paratë e pranuar nga aktivitetet operative
2	Paratë e dhëna për aktivitete operative
A	Neto rritjet(zvogëlimet) nga aktivitetet operative (1-2)
3	Paratë e pranuar nga aktivitetet investive
4	Paratë e dhëna për aktivitetet investive
B	Neto rritjet(zvogëlimet) nga aktivitetet investive (3-4)

5	Paratë e pranuar nga aktivitetet financuese
6	Paratë e dhëna për aktivitetet financuese
C	Neto rritjet(zvogëlimet) nga aktivitetet financuese(5-6)
D	Gjendja e parasë së gatshme në fillim të vitit
E	Gjendja e parasë së gatshme në fund të vitit D+/-A, +-B, +/-C

4.5. Pasqyra e ndryshimeve në kapital

Të gjitha ndryshimet në zërat e kapitalit, që kanë ndodhur në njësinë ekonomike raportuese gjatë një periudhe kontabël, do të regjistrohen në pasqyrën e ndryshimit të kapitalit.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital paraqet veças:

- Fitimin ose humbjen neto për periudhën kontabël, siç regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave;
- Të ardhurat dhe shpenzimet që janë regjistruar direkt në rezervat e kapitalit, në përputhje me politikat kontabël të kërkuara apo të lejuara në SKK të tjera;
- Efektin e ndryshimit të politikave kontabël në zërat e kapitalit;
- Efektin e rregullimit të gabimeve në zërat e kapitalit;
- Kontributet nga aksionarët në kapital;
- Shpërndarjet e kapitalit tek aksionarët;
- Veprimet me aksionet e thesarit;
- Rritja dhe pakësimi i rezervave;
- Veprime të tjera ekonomike, me efekt në zërat e kapitalit.

SHEMBUJ:

1. Janë dhënë llogaritë e bilancit për kompaninë “Rex” në fund të vitit fiscal. Përgatitni bilancin ku tregohet që Asetet = Detyrimet + Ekuiteti i pronarit. Të dhënat janë si vijon: llogaritë e arkëtuara 14.150 €, ndërtesa 79.500 €, para 11.200 €, pajisjet 72.750 €, lule dhe bimë 24.780 € zhvlerësimi i akumuluar 5.500 €, dëftesa të pagueshme 38.000 €, llogaritë e pagueshme 14.000 €, humbja 1.200 €, kredi afatshkurtër 25.000 €, pengu i pagueshëm 30.000 €, kapitali i pronarit 93.080 €, qiraja e parapaguar 12.000 €, TVSH e pagueshme 10.000 €.

Zgjidhja:

BILANCI KONTABËL

	ASETET	SHUMA		DETYRIMET	SHUMA
1	Paraja	11.200 €	1	Llogaria e Paguar	14.000 €
2	Llogaria e Arkëtuar	14.150 €	2	Dëftesa e Paguar	38.000 €
3	Qiraja e Parapaguar	12.000 €	3	Pengu i Paguar	30.000 €
A	Gjithsej Asetet Afatshkurtër	37.350 €	4	TVSH e Paguar	10.000 €
4	Ndërtesa	79.500 €	5	Kredi Afatshkurtër	25.000 €
5	Pajisjet	72.750 €	D	Gjithsej Detyrimet Afatshkurtër (D=1+2+3+4+5)	117.000 €
6	Lule dhe Bimë	24.780 €	6	Kapitali i Pronarit	93.080 €
7	Zhvlerësimi i Akumuluar	-5.500 €	7	Humbja	-1.200 €
B	Gjithsej Asetet Afatgjatë (B=4+5+6)	171.530 €	E	Gjithsej Ekuiteti (E=6+7)	91.080 €
C	Gjithsej Asetet (C=A+B)	208.880 €	F	Gjithsej Detyrimet + Ekuiteti i pronarëve (F=D+E)	208.880 €

Ekuacioni i Kontabilitetit:

ASETET = DETYRIMET + EKUITETI I PRONARËVE

A = D + E

208.880 € = 117.000 € + 91.880 €

208.800 € = 208.880 €

2. Nga të dhënat e mëposhtme, përpilo pasqyrën e të ardhurave: Shpenzimet e furnizimit 2.500 €, Shpenzimet e pagave 6.000 €, Shpenzimet komunale 350 €, Kostoja e mallit të shitur 34.500 €, Të hyrat nga shërbimet 5.000 €, Shpenzime të qirasë 3.000 €.

Zgjidhja:

PASQYRA E TË ARDHURAVE		
1	Të hyrat nga shitja	40.000 €
2	Të hyrat nga shërbimet	5.000 €
A	Gjithsej të hyrat (A=1+2)	45.000 €
B	KMSH	34.500 €

C	Fitimi Bruto (C=A+B)	10.500 €
1	Shpenzimet e pagave	6.000 €
2	Shpenzimet e qirasë	3.000 €
3	Shpenzimet e furnizimeve	2.500 €
4	Shpenzimet e komunaleve	350 €
D	Gjithsej Shpenzimet Operative (D=1+2+3+4)	11.850 €
E	Fitimi(E ardhura) operative (E=C-D)	-1.350 €
G	Taksat	0 €
F	Fitimi (Humbja) neto (F=E-G)	-1.350 €

3. Nga të dhënat e mëposhtme përpilo Pasqyrën e ndryshimit në ekuitet: Kapitali i pronarit në fillim të vitit 285.000 €, Fitimi i mbajtur në fillim të vitit 175.000 €, E ardhura neto 86.000 €, Dividenda 50.000 €.

Zgjidhja:

PASQYRA E FITIMEVE TË MBAJTURA		
A	Kapitali i pronarit në fillim	285.000 €
B	Fitimi i mbajtur në fillim të vitit	175.000 €
C	E ardhura neto	86.000 €
D	Dividenti	50.000 €
E	Fitimi i mbajtur në fund (E=A+B+C+D)	496.000 €

4. Nga të dhënat e mëposhtme të kompanisë “X” përpilo Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë: Pranuar për mallin 65.000 €, Pranuar për shërbimet e kryera 8.200 €, Pranuar si parapagim i qirasë 3.600 €, Blerja e inventarit 50.000 €, Paguar për konkursin e shpallur 180 €, Paguar për paga 950 €, Paguar për qiranë e parapaguar 6.000 €, Paguar për sigurimin e parapaguar 2.400 €, Blerja e pajisjeve 63.800 €, Huazimet nga banka 80.000 €.

Zgjidhja:

I	VEPRIMTARITË OPERATIVE	
	Para në fillim	0
A	Grumbulluar nga konsumatorët (A=1+2+3)	76.800 €
1	Pranuar për mallin e shitur	65.000 €
2	Pranuar për shërbimet e kryera	8.200 €
3	Pranuar si parapagim i qirasë	3.600 €
B	Blerja e inventarit	-50.000 €
C	Gjithsej pagesa për mallra dhe shërbime: (C=1+2+3+4)	-9.530 €
1	Paguar për konkursin e shpallur	-180 €
2	Paguar për pagat e paguara	-950 €
3	Paguar për qiranë e parapaguar	-6.000 €
4	Paguar për sigurimin e parapaguar	-2.400 €
D	Gjithsej Veprimtaritë Operative [D=A+(-B)+(-C)]	17.270 €
II	VEPRIMTARITË INVESTUESE	
1	Blerja e Pajisjeve	-63.800 €
E	Gjithsej Veprimtaritë Investuese (E=1)	-63.800 €
III	VEPRIMTARITË FINANCUESE	
	Huazime nga bankat	
1	Kapitali i investuar	80.000 €
F	Gjithsej Aktiviteti Financues (F=1)	80.000 €
G	Rritja neto e parasë (G=D+(-E)+F)	33.470 €
	Cash Balanca Fillestare	0
H	Cash Balanca Përfundimtare	33.470 €

5. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31.12.2015

Përshkrimi	Kapitali Fillestar	Fitimet i akumuluar	Gjithsej
Gjendja më 01.01.2015	1.164.000	300.000	1.464.000

Investimet e pronarëve	60.000		60.000
Tërheqjet e pronarëve	(20.000)	452.675	(20.000)
Shpërndarja e dividendit		(20.000)	(20.000)
Fitimi i periudhës (2015)		452.675	452.675
Gjendja më 31.12.2015	1.204.000	732.675	1.936.675

5. Kredithënia në Kosovë dhe vlerësimi i aftësisë kreditore

5.1. Vlerësimi i aftësisë kreditore nga ana e bankave

Vlerësimi i aftësisë kreditore është proces tejet i rëndësishëm tek çdo bankë, pasi që varësisht nga ky vlerësim në masë të madhe varet edhe fati i kredisë së lejuar në treg.

Egzistojnë metoda të ndryshme të vlerësimit të aftësisë kreditore të klientit por metoda më e përhapur është metoda që njihet si "5C". Në kuader të kësaj metode trajtohen faktorët në vijim:

- Karakteri(Character)
- Kapitali(Capital)
- Kolaterali(Corateral)
- Kesh Flou(Cash flow)
- Kushtet(Conditions)

Autorë të ndryshëm mund të përdorin edhe faktore tjere

Bankat komerciale në Kosovë vlersëojnë shumë deri në aprovimin apo refuzimin e kredisë për një biznes që ka aplikuar. Bankat kërkojnë shumë dokumente dhe duan të dinë shumë detaje në mënyrë që të vlerësojnë sa më mirë aftësinë kreditore të një biznesi. Ato se çka thonë bizneset duhet edhe të jenë të dokumentuara si kemi rastin kur klienti thotë se ka një numër të caktuar të shitjeve atëherë banka kërkon deklaratimet në ATK, nëse nuk i ka kërkon pasqyrat financiare, kërkon librin e blerjeve/shitjeve, nëse klienti kërkon shumë të madhe dhe pohon se ka edhe të ardhura tjera duhet të dokumentojë përmes gjendjes së llogarisë ku e merr të ardhurën ose ndonjë kontratë që dëshmon për të ardhurën e shumë të tjera të cilat varen nga aktiviteti i biznesit dhe nga shuma e kredisë që ka aplikuar klienti.

Nëse klienti ka shitje të vogla dhe nuk mund të përballojë këstin e caktuar në këto raste banka duhet që të ulë shumën e kredisë nëse pajtohet edhe klienti përndryshe klienti nuk mund të marrë shumën e kërkuar. Ka shumë raste të tilla që ndodhin gjatë kredithënies në Kosovë ku në të shumtën e rasteve bizneset pajtohen për uljen e shumës së kredisë por ka të atillë që duan të mbajnë

shumën e njejtë që kanë kërkuar por për këtë banka kërkon nga ato biznese që të lënë peng edhe diçka tjetër me vlerë – ndonjë veturë që të mbulohet shuma e kredisë. Kjo veturë ose duhet të jetë në emër të biznesit, pronarit, garantuesit, huamarrësit për t'u lënë peng.

Bizneset shpesh janë të pakënaqura nga kushtet që kanë bankat në Kosovë por kjo ndodh në mënyrë që mos të vijë deri tek kredia jo përformuese apo siç njihen ndryshe kreditë e këqija.

5.2. Faktorët e formimit të potencialit kreditor

Në procesin e krijimit të potencialit financiar e kreditor ndikojnë shumë faktorë:

- 1) Kreditë e Bankës Qendrore,
- 2) Rezervat e detyrueshme,
- 3) Shëndërrimi i depozitave në para të gatshme,
- 4) Operacionet bankare,
- 5) Politika e normës së kamatës në kredi e depozita,
- 6) Struktura e depozitave,
- 7) Struktura e kredive të dhëna etj.

Kreditë e Bankës Qendrore – paraqesin njërin nga faktorët më të rëndësishëm të formimit të potencialit financiar, sidomos për bankat e reja, bankat e ekonomive me akumulim të vogël, bankat që varen në një masë të gjerë nga kreditë e Bankës Qendrore etj.

Rezervat e detyrueshme – ndërrimi i normës së rezervave të detyrueshme ndikon në mënyrë direkte në potencialin financiar të bankave afariste. Kur Banka Qendrore bën rritjen e normës së rezervave të detyrueshme, atëherë zvogëlohet potenciali financiar i bankave i bankave.

Shëndërrimi i depozitave në para të gatshme – paratë e gatshme mund t'i krijojë vetëm Banka Qendrore, ndërsa me shpenzimin e parave të gatshme, që është kryesisht në duart e popullsisë, paraja e gatshme shndërrohet në para depozitare dhe në këtë mënyrë rritet potenciali financiar i bankave.

5.3. Kreditimi bankar me afat të shkurtër

Banka lejon kredi me afat të shkurtër nga mjetet e grumbulluara në formë të depozitave me të parë, nga kreditë aftashkurtër të Bankës Qendrore dhe kreditë afatshkurtër të bankave të tjera. Gjatë lejimit të kredive afatshkurtër banka duhet t'i përmbahet parimit të likuiditetit dhe të sigurisë, d.m.th. të sigurojë kthimin e kredisë së lejuar afatshkurtër pas skadimit të afatit të kthimit të kredisë. Për këtë arsye, banka vazhdimisht duhet të hulumtojë aftësinë kreditore dhe bonitetin e kërkuesit të kredisë, me ç'rast ajo analizon afarizmin e tërësishëm, likuiditetin, rentabilitetin dhe rregullsinë lidhur me përmbushjen e obligimeve të kërkuesit të kredisë dhe ia lejon kredinë atij kërkuesi, i cili ofron të gjitha garancitë se kredia do të kthehet brenda afatit të kontraktuar.

Shfrytëzues të kredive afatshkurtër të bankave mund të jenë:

- 1) Organizatat ekonomike,
- 2) Veprimtaritë joekonomike,
- 3) Bankat afariste,
- 4) Prodhuesit bujqësorë,
- 5) Popullsia dhe
- 6) Organizatat që merren me tregti të jashtme.

5.3.1. Kreditimi i organizatave ekonomike

Pjesën më të madhe të kredive bankare afatshkurtër e përbëjnë kreditë që u lejohen organizatave ekonomike.

- a) Kushtet e përgjithshme të kreditimit – Banka përherë duhet të jetë në kontakt me organizatat ekonomike, me të cilat ka marrëdhënie afariste të përhershme, duke përcjellë afarizimin e tyre, si dhe duke mbledhur dokumentacionin përkatës, në mënyrë që të jetë në gjendje që ta vlerësojë aftësinë kreditore të çdo organizate ekonomike. Organizata ekonomike ka aftësi kreditore nëse realizon rezultat financiar pozitiv, i kthen kreditë me kohë, e ka të rregulluar si duhet afarizimin financiar dhe e ka kontabilitetin azhur, si dhe nëse tregon realisht pasurinë dhe obligimet e saj.
- b) Procedura e kreditimit – përfshinë kërkesën kreditore dhe shqyrtimin e asaj kërkesës nga ana e bankës.

Kërkesa kreditore duhet të përfshijë këto elemente:

- Qëllimin e shfrytëzimit të kredisë,
- Mënyrën e shfrytëzimit,
- Shumën e kredisë,
- Kushtet e shfrytëzimit (dinamika e shfrytëzimit, afati i kthimit, mënyra e kthimit etj),
- Garancën që ofrohet dhe
- Shpjegimet plotësuese dhe dokumentacionin që parashihet për llojet e caktuara të kredive.

Përpunimi i kredisë kreditore nga ana e bankës duhet të bazohet në këtë dokumentacion:

- Planin e prodhimit, përkatësisht të qarkullimit për vitin vijues sipas sasisë së vlerës,
- Llogarinë përfundimtare për vitin paraprak,
- Llogarinë periodike për vitin vijues,
- Llogaritë mbi shumën minimale të mjeteve xhiruese dhe
- Pasqyra e kërkesave nga blerësit sipas afatit.

Banka ka drejtë të vërtetojë gjërat edhe duke shkuar në organizatën ekonomike, po ashtu edhe mund të bëjë kontrollin edhe gjatë shfrytëzimit të kredive.

Pas shqyrtimeve të elementeve përpilohet lënda dhe dorëzohet tek organi kompetent që të merr vendimin mbi lejimin e kredisë. Kur vendimi është pozitiv pastaj lidhet kontrata me shfrytëzuesin, ndërsa nëse kërkesa refuzohet banka duhet të i shfaq shpjegimet përkatëse kërkuarit të kredisë. Dhe në fund pasi të miratohet kërkesa e kredisë, faza e fundit ka të bëjë me pagimin e shumës së kredisë në xhirlogarinë e debitorit.

c) Llojet e kredive sipas destinimit – bankat mund të lejojnë kredi për qëllime të caktuara:

- Për qarkullimin e mallrave,
- Për stoqe të caktuara,
- Për punë të caktuara dhe
- Për punë specifike.

5.3.2. Kreditimi i veprimtarive joekonomike

Për shkak të mungesës së të hyrave dhe financimit të parregullt, bankat mund t'u japin kredi po ashtu edhe organizatave joekonomike, si: komunave, fondeve të arsimit, enteve të sigurimit social, enteve të punësimit etj.

5.3.3. Kreditimi i bankave afariste

Për sigurimin e likuiditetit dhe plotësimin e potencialit kreditor, Banka Qendrore mund t'u lejojë kredi bankave afariste, nëse ato:

- I përmbahen politikës kreditore,
- Kontrollonjë shfrytëzimin e kredive sipas destinimit të tyre,
- Kujdesen për aftësinë kreditore të debitorëve të vet,
- Kujdesen për likuiditetin e vet, si dhe likuiditetin e komitentëve të vet,
- Kanë afarizëm rentabil dhe i kryejnë me rregull obligimet dhe
- Bankës Qendrore rregullisht i dërgojnë raportet e kontabilitetit, bilancet kreditore dhe shënimet e tjera mbi likuiditetin dhe aktivitetin kreditor të bankës.

5.3.4. Kreditimi i prodhuesve bujqësore

Kreditë e tilla jepen me afat deri 1 vjet, por mund të jepen edhe në formë të avansit për material riprodhues (farat, plehrat etj), soe në formë të parave të gatshme.

5.3.5. Kreditë konsumuese

Kreditë konsumuese jepen me qëllim blerjen e aparateve për amvisni, mobilieve, automobilave etj.

Disa nga karakteristikat kryesore të kredive konsumuese janë:

- ✓ Ato i japin bankat në bazë të depozitave të kursimit të grumbulluar dhe mjeteve të tjera të afatëzuara, e në disa raste ato i japin edhe organizatat tregtare,
- ✓ Kreditë konsumuese mund ta marrë çdo person që është në marrëdhënie të përhershme
- ✓ pune dhe ata që kanë të ardhura të rregullta (pensionistët, invalidët etj),

- ✓ Kreditë konsumuse jepen edhe për blerjen e produkteve industriale, lëndëve djegëse, për rregullimin e prishjeve në objektet e banimit, blerjen e automobilave etj
- ✓ Afati i kthimit është deri 2,5 vjet, kurse për automobile është afati deri 3 vjet etj.

5.3.6. Kreditimi i tregtisë së jashtme

Kreditë për tregti të jashtme i kanë disa karakteristika si p.sh: si marrja e mallrave dhe e shërbimeve nga bota e jashtme, ashtu edhe dhënia e tyre, i nënshtrohet lejes paraprake, në mënyrë që të harmonizohen nevojat e vendit me importin e eksportin, dhe që të sigurohet që transaksionet e tilla, të arrijnë efektin sa më të madh.

Procedura e lejimit të kredive të tilla duhet të jetë e shpejtë dhe ekspeditive dhe këtu nuk tolerohen formalitetet e konkursit, hulumtimi i gjatë i aftësisë kreditore.

Këto kredi mund të shfrytëzohen përnjëherë (kur shuma është e fiksuar), në transhe (kur nuk dihet shuma e saktë dhe data e shfrytëzimit, por vetëm shuma maksimale dhe afati i fundit, deri kur do të shfrytëzohet kredia.

Gjatë marrjes- dhe dhënies së kredisë ekzistojnë 3 mundësi: kredinë ta japim apo ta marrim në valutë të vendit, ose në valutë të partnerit tone, ose në ndonjë valutë të ndonjë vendi të tretë

Varësisht nga mënyra e sigurimit të kredive, kreditë mund t'i ndajmë në kredi të hapura (kur nuk ka kurrfarë parakushtesh për shfrytëzimin e tyre) dhe kredi dokumentare (kur shfrytëzimi kushtëzohet me dorëzimin e dokumenteve të caktuara ose letrave me vlerë).

Kreditë për tregti të jashtme mund të rrjedhin prej burimeve të ndryshme e të cilat mund të jenë: bankare, komerciale, ndërbankare, ndërshtetërore, organizatat ndërkombëtare, dhuratat e ndihmat.

Kreditë komerciale për tregti të jashtme – janë zakonisht kredi që lidhen kur kanë të bëjnë me shuma të vogla, dhe janë ato kredi të të cilat një partner ia jep tjetrit mallrat apo shërbimet, ashtu që pagesa të bëhet më vonë.

Kreditë bankare – të cilat ua japin bankat komitentëve të vet nga burimet vetjake që të mund të kryhet ndonjë transaksion, dhe duhet cekur së këto kredi lejohen në bazë të kontratës mbi kredinë, që lidhet në mes të ndërmarrjes për tregti të jashtme dhe bankës.

Kreditë ndërbankare – të cilat bankat e huaja u japin bankave të vendit, ose bankat e vendit bankave të jashtme.

Format e kreditimit të tregtisë së jashtme janë:

- Kreditë për eksport
- Kreditë për import
- Kreditë për shërbime, riekспорт etj, dhe
- Kreditë për punët ndërtimore në botën e jashtme.

5.4. Kreditimi bankar me afat të gjatë

Te kreditë me afat të gjatë - kemi të bëjmë me deponimin e mjeteve monetare për financimin e investimeve, d.m.th. riprodhim të zgjeruar.

Pasi që me kredi afatgjatë investohen mjetet monetare të riprodhimit të zgjeruar, d.m.th. në mjete themelore, me të cilat do të zgjerohen riprodhimi ekzistues dhe baza prodhuese, shtron nevojën e respektimit rigoroz të parimeve, sipas të cilave riprodhimi i zgjeruar mund të bëhet nga akumulimi i krijuar nga teprica e realizuar e produkteve, apo nga mjetet e kursyera qoftë të personave juridikë apo fizikë. Kështu që burimet e mjeteve për kredi afatgjatë janë të përcaktuara saktësisht dhe janë të paangazhuara në prodhim dhe të lira për një afat më të gjatë.

Esenca e kredive me afat të gjatë qëndron në ndërmjetësimin e bankës në mes të njësive ekonomike, të cilat të ardhurat e realizuara nuk i shpenzojnë në tërësi si dhe njësive ekonomike të cilave u mungojnë mjetet financiare për financimin e investimeve. Me këtë rast banka e bart fuqinë blerëse të subjekteve ekonomike suficitare në subjektet ekonomike deficitare, pa ndikuar me atë rast në lartësinë e masës monetare ekzistuese.

Karakteristikë tjetër e kredive afatgjata është edhe zgjedhja e objekteve të investimeve. Mjetet e akumuluar investohen në ndërtimin e mjeteve të reja të punës me të cilat do të zhvillohen prodhimtaria e re, për të cilën duhet që para së të marrin lejimin e kredisë të shihet edhe produktiviteti a do të jetë i lartë, kualitativ dhe rantabil dhe se a do të ketë realizimin e sigurt në tregun e vendit apo të jashtëm.

Disa nga specifikat që i dallojnë nga kreditë e tjera janë;

- Normë më të lartë të kamatës, gjë që duhet të sigurojë rentabilitetin e investimeve,
- Mbulesën tjetër për kredinë e lejuar, që e përbëjnë hipoteka e bankës mbi objektet e ndërtuara, tokën dhe pasurinë tjetër të kërkuesit të kredisë,
- Rrezikun më të madh për kredinë e lejuar, që rezulton nga afati i gjatë,
- Teknikën tjetër të lejimit të kredisë afagajtë, e cila kërkon që banka të disponojë kuaro të veçanta profesionale.

6. Faktorët e vlerësimit të aftësisë kreditore të klientit

Faktorët që ndikojnë në aftësinë kreditore të klientit janë të shumta si p.sh tek personat fizik ka ndikim paga e klientit, është me rëndësi që paga të merret përmes bankës me një afat të caktuar dhe në bazë të pagës caktohet shuma që mund të merr klienti, duhet shikuar historinë kreditore nëse ka klienti për të shikuar se si ka paguar nëse ka pasur kredi në të kaluarën, pra shikohen këto dhe detaje tjera varësisht nga politikat e bankave komerciale dhe vendoset për aprovim apo refuzim të kredisë. Nëse aprovohet nënshkruhet marrëveshja e kredisë dhe bëhet disbursimi i kredisë por nëse refuzohet analisti kreditor e ka për detyrë të i tregojë klientit se pse i është refuzuar kredia.

Ndërsa tek rasti i personave juridikë – bizneseve është procedura më e gjatë dhe kërkohen më shumë dokumente, shikohen më shumë gjëra fillimisht duhet takuar me klientin për të biseduar për kushtet që duhet plotësuar nga të dy anët, klienti duhet të tregojë vendin e biznesit, të prezantojë shitjet (pasqyrat financiare), paisjet, ndonjë veturë nëse nuk ka kolateral të mjaftueshëm, të gjejë një garantues apo bashkëhuamarrës gjë e cila varet nga shuma e kredisë dhe nga politika e bankës komerciale ku ka aplikuar. Analisti kreditor duhet të pregadit lëndën por fillimisht duhet të shikojë historitë kreditore të të gjitha palëve që do të përfshihen në kredi siç janë: historia kreditore e pronarit/pronarëve, biznesit si dhe garantuesit/bashkëhuamarrësit. Analisti duhet të pregadit lëndën pasi shikimit të historive kreditore dhe nëse janë me histori të mirë vazhdon tutje me pregaditjen dhe shqyrtimin e lëndës për të dërguar në departamentin e riskut. Nëse analisti merr përgjigjen për aprovimin e kredisë vazhdohet me nënshkrimin e kontratës së kredisë nga palët e përfshira por nëse merr përgjigjen për refuzimin e kësaj kredie analisti është ai që duhet të nifotojë klientin dhe t'i tregojë se pse ju ka refuzuar kjo kredi.

6.1. Procesi i kreditimit nga ana e bankave komerciale

Hapat e procesit të kreditimit të biznesit nga banka komerciale janë:

- Aplikimi nga biznesi për kredi në bankën komerciale,
- Kontaktimi nga analisti kreditor i bankës,
- Bashkëbisedimi i pronarit me analistin, ku pronari i biznesit tregon kërkën e tij ndërsa analisti tregon ofertën – kushtet e marrjes së kredisë si dhe normën e kredisë për shumën e caktuar.
- Nëse pronari është dakord për marrjen e kredisë me kushtet dhe normën e treguar vjen hapi tjetër për të vizituar klientin në biznes dhe për marrjen e dokumenteve.
- Analisti pasi vizitës dhe kompletimit të dokumenteve përkatëse duhet të përgatit lëndën e kredisë dhe ta dërgojë në departamentin e riskut aty ku shikohet lënda dhe marrin vendimin për aprovimin ose refuzimin e kredisë.
- Nëse kredia aprovohet atëherë nënshkruhet kontrata mbi kredinë nga analisti, pronari, bashkëhuamarrësi ose garantuesi dhe në fund arrihet edhe disbursimi i kredisë në llogarinë e biznesit.

6.2. Kreditë në shfrytëzim në sistemin bankar në Kosovë ndër vite

Kreditë të cilat ofrohen në Kosovë janë të ndryshme si: kredi personale, kredi për shtëpi, kredi për renovim të shtëpisë, kredi për regjistrim të automjetit, kredi për gra, kredi start up për gra, kredi hipotekare, kredi biznesi (ku merren për qëllime të ndryshme), kredi konsumuese, mbitërheqje, kredi bujqësore, kredi për shkollim, kredi për blerje të veturës etj., që varen nga banka që jep llojin e kredisë. Sa i përket kredive që ofrohen për biznese kemi kredi të ndryshme të cilat varen edhe nga natyra e bizneseve duke filluar nga kredia për blerje malli, për blerje të paisjeve të ndryshme, për blerje të veturave, për blerje të autobusve, për investime të ndryshme, për renovim në biznes etj. Llojet e kredive varen se edhe ma çfarë aktiviteti merret biznesi dhe një nga kreditë që nuk duan ta marrin janë kreditë hipotekare.

6.2.1. Trendi i kredidhënies ndër vite

Në figurat e mëposhtme janë paraqitur kreditë e marra nga bizneset në Kosovë gjatë viteve të fundit të llogaritura në USD për muaj.



Figura 2. Kreditë në vitin 2020 në USD në Kosovë (Burimi: Ceic Data)



Figura 3. Kreditë në vitin 2021 në USD në Kosovë (Burimi: Ceic Data)




Figura 4. Kreditë në vitin 2022 në USD në Kosovë (Burimi: Ceic Data)

6.2.2. Kreditë e këqija dhe performanca bankare

Bankat janë ofruesi kryesor i kapitalit të jashtëm për sektorin e NVM-ve në vendet e zhvilluara dhe në vendet në zhvillim (Vera & Onji, 2010; Ono & Uesugi, 2009; Wu et al, 2008; Carey & Flynn, 2005; Cole & Wolken, 1995).

Keasey dhe McGuinness (1990) argumentuan faktin se financimi bankar është më i shtrenjtë në krahasim me burimet e tjera të financimit, por në fakt gjeneron një normë më të lartë të kthimit për NVM-të.

Dhe më tej ata erdhën në përfundim se financat bankare mund të ndihmojnë NVM-të të arrijnë nivelin më të mirë të performancës në krahasim me burimet e tjera të financimit.

Po ashtu edhe nga perspektiva e bankës, segmenti i NVM-ve përfaqëson një pjesë strategjike fitimprurëse të biznesit të bankës. Në këtë drejtim, de la Torre, Martinez dhe Schmukler (2009) e përshkruan marrëdhënien në mes të NVM-ve dhe bankave si integrale. Ata shpejguan edhe se bankat nuk ofrojnë vetëm kapitalin e nevojshëm për sipërmarrësit për të krijuar NVM të reja apo zgjerimin e atyre ekzistuese por ato gjithashtu ofrojnë një shumëllojshmëri të shërbimeve si dhe produkteve financiare.

Kredi të këqija llogariten ato kredi kur klientët nuk arrijnë t'i kthejnë me kohë kështu e kredive, atëherë ato do të bëhen problematike dhe nëse ky problem nuk do të zgjidhet brenda afatit prej 90 ditësh, atëherë këto kredi ndryshe njihen edhe si kredi jopërformuese.

Kosova ka normën më të ulët të kredive të këqija në Ballkan, dhe kjo tregon cilësinë e mirë të portofolit kreditor. Kjo normë e ulët e kredive të këqija tregon se Kosova ka një sektor bankar të shëndoshë dhe e mira tjetër është që kjo duhet të përdoret si model për të treguar gjendjen e përgjithshme që ofron ekonomia e tregut të Kosovës dhe është një informatë shumë e rëndësishme edhe për investitorët e huaj të cilët dëshirojnë të vijnë dhe të investojnë në Kosovë.

Sipas ekspertëve për çështje financiare pohojnë se procedurat si dhe kriteret e shumta për aprovimin e kredisë në bankat komerciale të cilat veprojnë në Kosovë janë faktorët kryesorë që kanë ndikuar që niveli i kredive joperformuese të mbetet në nivel të ulët.

Ndërsa sipas ekspertit për çështje financiare Milazim Abazi ka pohuar se niveli i kredive të këqija vazhdimisht ka shkuar në rënie dhe kjo nënkupton se BQK-ja ka një mbikëqyerje të mirë të sistemit kreditor në Kosovë, kurse vetë bankat përcjellin kujdesshëm procesin e aplikimit si dhe aprovimit të kredisë po ashtu edhe vetë qytetarët janë të përgjegjshëm ndaj obligimeve financiare.




Figura 5. Kreditë e këqija në Kosovë Janar 2022-Shkurt 2023 në % (Burimi: Ciec Data)

Konkluzione dhe Rekomandime

6.1.Konkluzione

NVM-të janë strumbullari i zhvillimit të cdo ekonomie çoftë ne vendet e zhvilluara apo edhe te ato në zhvillim.Jo me kote trajtohen si gjaku i freskët I çdo ekonomie.

Edhe tek ne, sektori i NVM-ve ka një rëndësi të madhe për krijimin e vendeve të reja të punës e cila ndikon edhe në uljen e varfërisë, Kosova duhet fokusuar shumë në ndërtimin e infrastrukturës, në uljen e korrupsionit për t'ia bërë qasjen më të lehtë bizneseve për t'u zhvilluar dhe duhet zhvilluar më shumë kuadro për t'i ndihmuar bizneset Start-Up për t'u zhvilluar.

Rritja e NVM-ve në Kosovë gjithmonë ka treguar trend pozitiv dhe numri i tyre krahasuar me ndërrmarjet e mëdha përben mbi 99% të bizneseve. Nga kjo konkludohet që roli dhe rëndësia e tyre për zhvillimin ekonomik të Kosovës është e një rëndësie të veçantë andaj bankat komerciale duhet të fokusohen më tepër në mbështetjen e këtij sektori pasi që rritja dhe fuqizimi i këtij sektori do të thote jo vetëm mbështetje për ekonomine por edhe për vet bankat që e mbështesin sektorin e tille të NVM-ve.

6.2 Rekomandime

Bazuar në shqyrtimin e literatures nga fusha e NVM-ve si dhe të financimit nga ana e bankave por edhe gjatë analizës gjatë tere punës së bërë në temën konkrete arrijmë që të nxjerrim disa rekomandime për një spekter të gjere akteresh: qofshin ata politikbërës, instucionet financiare, bizneset etj.

Konkretisht:

-Për politikbërësit (Banke qendrore, ATK, agjensionet shteterore) duhet që të krijojnë politika lehtësuese lidhur me regjistrimin dhe mbështetjen e ndërrmarjeve të vogla dhe të mesme.

-Për bankat komerciale: të rishikojnë kushtet e kreditimit (jo vetëm normat e interesit por edhe grace periudhen, kohëzgjatjen si dhe mbulueshmërinë me kolateral për shkak se shpesh here janë kushte që e rëndojnë tej mase biznesin e nuk e mbështesin faktikisht me rastin e marrjes së kredise.

-Për NVM-te: Të gjitha bizneset duhet të jenë më korrekte me rastin e plotësimit të dokumentacionit të cilin e dorëzojnë në bankë. Shpesh here ndodh që bizneset të rrisin treguesit e performances në menyrë që të marrin kredi më lehtë. Mirëpo kjo u shkakton telashe drejtëpërdrejtë bizneseve për shkak se kanë prezentuar gjendje jo-reale si dhe bankave të cilat mund të futen në lajthitje me rastin e vlerësimit të aftësisë kreditore të atij biznesi .

LITERATURA

1. Sabahudin Komoni (2009). FINANCAT, PRISHTINË, 2009
2. Armand Krasniqi (2014). E DREJTA BIZNESORE, 2014
3. Prof.ass.dr.Shefket Jakupi (2017). PARIMET BAZË TË KONTABILITETIT, 2017
4. Qazim Tmava:(2021)Menaxhmenti bankar-Ligjërata te autorizuara
5. 5.Raportet vjetore te BQK-së(2015-2020)
6. 6.Raportet vjetore te SHBK-së (2015-2020)
7. 7.Bankat në Kosovë, rehat me kreditë e këqija - Telegrafi - Telegrafi
8. 8Kosovo Total Loans | 2000 - 2023 | Economic Indicators | CEIC (ceicdata.com)
9. 9.Kosovo Non Performing Loans Ratio, 2010 – 2023 | CEIC Data

Thënie për sukseset



“Disa njerëz ëndërrojnë për suksesin, ndërsa të tjerët ngrihen çdo mëngjes për ta bërë atë realitet.” - Wayne Huizenga



“Suksesi rezulton nga tejkalimi i çdo dështimi të radhës pa humbur asnjëherë entuziazmin.” - Winston Churchill



“Mos syno të jesh i suksesshëm por të jesh i vlefshëm.” - Albert Einstein



“Sekreti i suksesit tonë mbetet fakti se nuk heqim dorë asnjëherë, as edhe një herë.” - Wilma Mankiller



“Për të qenë i suksesshëm nuk ka nevojë të jesh gjeni apo vizionar apo të kesh një diplomë universitare. Të nevojitet vetëm një sistem orientimi dhe një ëndërr.” - Michael Dell



“Unë ia atribuoj suksesin tim faktit se – nuk bëra apo nuk pranova justifikime.” - Florence Nightingale


Thënie për bizneset



“Çdo biznes i madh fillon i vogël.”
Richard Branson

“Udhëheqësit e mirë të biznesit krijojnë një vizion,
artikulojnë dhe zotërojnë me pasion atë dhe e shpiejnë
deri në përfundim.”

Jack Welch




“Dështimi nuk duhet të na frikësoj. Po nga dështimi vie
rritja më e madhe.”

Dee Hock

“Bëni diçka që njerëzit duan” do të thotë të krijosh një
kompani për të cilën njerëzit duan të punojnë.”

Sahil Lavingia



“Ju nuk ndërtoni një biznes, ju ndërtoni njerëzit, pastaj
njerëzit ndërtojnë biznesin.”

Zig Ziglar

